

Bashkia: PATOS

Kryetar: RAJMONDA BALILAJ

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të sigurohet transport publik i aksesueshëm në të gjitha zonat e reja të shtuara të bashkisë
2. Do të kryhet mirëmbajtje e infrastrukturës urbane me synim që të mbulojë të gjithë territorin e bashkisë së re
3. Do të kryhet konsolidim i sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale në qytet si dhe shtrirja më pas në të gjithë territorin
4. Do të kryhet rritja e sipërfaqes së mbulimit me ndiçim rrugor në rrugë e lulishte si dhe mirëmbajtje e ndiçimit ekzistues
5. Do të kryhet mirëmbajtje dhe shtim i sipërfaqeve të varrezave publike
6. Do të ndërtohet rrjeti ujësjellës për Bashkinë e Patosit
7. Do të kryhet sistemim i përroit në krah të rrugës "Sotir Xoxe"
8. Do të kryhet rikonstruksion i Bashkisë Patos
9. Do të kryhet rikualifikim urban i zonës informale në bllokun industrial të lagjes "29 Marsi"
10. Do të kryhet rikualifikim i zonës informale, zonës Vresht në Lagjen e Re
11. Do të kryhen kanalizimet e ujërave të zeza në Griz (Velaj dhe Lenginas)
12. Do të kryhet rikonstruksion i plotë i rrugës "Unaza"
13. Do të kryhet rehabilitim i qendrës së qytetit
14. Do të kryhet rikonstruksion i rrugës Griz-Lenginas (Unazë-Griz-Velaj)
15. Do të kryhet rikualifikim urban i pjesshëm i "Lagjes së Re"
16. Do të kryhet shtrimi i rrugës kryesore në Rërës
17. Do të kryhet KUZ në Patos (periferi), Dukas, Rërës, Vresht
18. Do të kryhet kanalizimi i ujërave të zeza në Frashër, Verbas dhe Sheqistë
19. Do të kryhet rikonstruksion i rrugëve të brendshme në Verbas-Sheqishtë-Frashër
20. Do të kryhet rikonstruksion i rrugës Fshat i Ri-Sheqistë
21. Do të ndërtohet ujësjellësi në Belinë (linjat e brendshme)
22. Do të kryhet rikonstruksion i rrugës së Kishës dhe rrugës së varrezave në Sheqishtë
23. Do të kryhet rikonstruksion i rrugëve: Ruzhdie-Gjynaçarë, Siqecë-Luar, Drenie-Siqecë
24. Do të kryhet rikonstruksion i rrugës Kasnicë poshtë-Kasnicë sipër

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të rikonstruktohet shkolla "Mustafa Matohiti"
2. Do të rikonstruktohet shkolla "Meleq Gosnishti"
3. Do të rihapet dega e teknologji naftë në arsimin profesional

4. Do të zhvillohet arsimi profesional në ekonominë e bujqësisë organike dhe blegtorisë
5. Do të kryhet promovimi dhe stimulimi i nxënësve ekselent
6. Do të rigjallërohet jeta kulturore, artistike dhe sportive në bashki
7. Do të sigurohen, në bibliotekën publike në bashki, projekte artistike për fëmijë dhe projekte social-kulturore
8. Do të kryhet organizimi i të rinjëve në formacione sportive
9. Do të kryhet ringritja e ekipit të futbollit "Albpetrol" në kategorinë e parë dhe përfaqësimi dinjitoz në kampionate dhe evente të rëndësishme sportive rajonale dhe kombëtare të ekipit në sportin e boksit dhe taekëndos
10. Do të kryhet mbështetje e çdo iniciative sportive private në shërbim të edukimit dhe zhvillimit të sportit
11. Do të krijohet një kënd sportiv në lagjen "Dukas"
12. Do të kryhet rikonstruksioni dhe rehabilitimi i të gjitha mjediseve sportive të bashkisë
13. Do të ngrihet një Qendër Rinore Multifunkionale në territorin e bashkisë
14. Do të kryhet mbështetje dhe rritje kapacitetesh për Grupe Rinore Këshillimore
15. Do të krijohen mundësitë për intershipe me programe afatshkurtër dhe afatmesëm
16. Do të krijohet një Pallat Sporti në territorin e bashkisë
17. Do të rikonstruktohet shkolla në Frashër

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të hartohen dhe zbatohen projekte pilot për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve kryesisht në qendrat e zonave të banuara Patos, Zharës, Rruzhdie
2. Do të vendosen kosha në zonat të cilat nuk mbulohen aktualisht me këtë shërbim
3. Do të krijohen mundësi për riciklimin e mbetjeve duke i kthyer në burim financimi e punësimi
4. Do të kryhet rikualifikim urban i zonave të pasistemuara dhe të ndotura në krijimin e lulishteve dhe parqeve çlodhës publik për moshën e tretë dhe fëmijët
5. Do të kryhet shtimi i sipërfaqeve të gjelbëra me mbjelljen e pemëve dhe ndërtimin e lulishteve në territorin e bashkisë
6. Do të kryhet edukim masiv për rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor
7. Do të kryhet përmirësimi i shërbimit të pastrimit, largimit e përpunimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë
8. Do të përmirësohet shërbimi i trajtimit, përpunimit, mbulimit dhe dizifektimit të vazhdueshëm të mbetjeve urbane në pikën e grumbullimit në Mazaren
9. Do të shtohet gjelbërimi rrugor duke mbjellë drurë të rinj si dhe duke kryer zëvendësimin e drurëve të dëmtuar në territorin e bashkisë
10. Do të ndërtohen korsitë e biçikletave përgjatë rrugëve kryesore të qytetit

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të sigurohet mbështetje për zhvillimin bujqësor dhe blegtoral duke nxitur krijimin e fermave bujqësore dhe blegtorale me projekte të mbarështimit si ekonomi familjare dhe industrisë agro- përpunuese
2. Do të kryhet mbështetje për fermerët me politika lehtësuese për shtimin e sipërfaqeve të mbjella me ullishte, vreshta e pemë frutore
3. Do të kryhet mbrojtja e tokës nëpërmjet rregullimit të pritave ekzistuese dhe ndërtimi i pritave të reja në këto zona për të ndaluar erozionin dhe shkarjen
4. Do të shtohet numri i agro-përpunuesve dhe do të krijohen pika grumbullimi të prodhimeve dhe ngritja e kantinave
5. Do të kryhet pastrimi i kanalit vaditës që furnizohet nga rezervuari i Kurjanit
6. Do të ngrihet shërbimi zoo-veterinar për mbarështimin e blegtorisë me synimin që të vihet mbi baza ligjore prodhimi i mishit, qumështit, vezëve, mjaltit dhe shpërndarja e materialeve racore
7. Do të ofrohet asistencë teknike për të orientuar fermat për prodhimin sipas zonave
8. Do të kryhet shtimi i komplekseve blegtorale dhe mbështetje me programe të veçanta
9. Do të kryhet ndërgjegjësim dhe asistencë fermerëve për ngritjen e fermave tregëtare të prodhimeve blegtorale dhe të fermave përpunuese të qumështit
10. Do të ndërmerren politika favorizuese për nxitjen e kooperimit dhe krijimin e fermave private (5-10 deri ne 20 ha)
11. Do të kryhet shtimi në mbi 40 ha i sipërfaqeve në sera dhe do të mbështeten fermerët duke negociuar me OSHE për sigurimin e energjisë
12. Do të kryhet pastrimi i gjithë rrjetit vaditës të zonës fushore të Bashkisë nëpërmjet krijimit të infrastrukturës së mjeteve të nevojshme
13. Do të krijohen PPP për ngritjen e strukturave magazinuese për produktet bujqësore ku të ketë kanale funksionale të skemës së sigurimit ushqimor që nga prodhimi deri tek magazinimi, paketimi, marketing dhe shitje
14. Do të realizohen programe të informimit dhe trajnimit të fermerëve duke përdorur trainer nga zona për skemat e financimit ekzistues nga Qeveria Qendrore si dhe grumbullimi i informacionit nga Donatorë të ndryshëm
15. Do të hartohet një Plan Veprimi për Zhvillimin e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Ushqimit
16. Do të zhvillohet Sektori i Zhvillimit Rural me specialist të aftë
17. Do të ngrihet një Grup Këshillimor për Bujqësinë dhe Blegtorinë
18. Do të ngrihet një fond kompetitiv për zhvillimin e fermave familjare
19. Do të nxitet tregu i prodhimit të bujqësisë organike
20. Do të kryhet infrastruktura e mjeteve për pastrimin e kanaleve kullues të III-të
21. Do të bashkërendohet puna me Bordin e Kullimit për pastrimin e kanaleve të I-ra dhe të II-ta kullues (rreth 18km), pastrimin e kanalit të pritësit të ujërave Grizë Lenginas, përroi i Zharrezës, i Frashërit, i kanalit C3 Beline
22. Do të kryhet monitorim i zhvillimit të sektorit bujqësor dhe blegtoral që nga proçesi i prodhimit të produkteve deri në sigurimin e tregut të prodhimit të tyre
23. Do të krijohet një traditë për tregjet shitës dhe mundësinë për të pasur ditë të veçanta tregu e promovimi do të jenë në kalendarin e punës për sektorin e zhvillimit rural

24. Pas aprovimit të ligjit për tokat bujqësore, brenda qershor 2016 do të arrihet konsolidimi i pronës tokë bujqësore
25. Do të kryhet procesi i regjistrimit të tokës pranë zyrave të regjistrimit, duke u bërë ndërmjetës midis fermerit dhe ZVRPP për të thjeshtuar procedurat e regjistrimit në mënyrë që të hapet tregu i tokës dhe fermerët e kanë më të lehtë për të vendosur tokën si koletaral në bankë duke lehtësuar procesin e kreditimit në bujqësi
26. Do të kryhen rrugët e parcelave në territorin e bashkisë
27. Do të kryhet përfundimi i regjistrimit fillestar për fshatrat ku nuk është kryer ky porçes
28. Do të kryhet pastrimi i rezervuarit të Zharezës si dhe lartësimi i digës së tij
29. Do të vihen në funksion pompat e ujit në fshatin Belinë (400 ha nën ujë)

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do ti jepet mundësi qytetarëve për të marrë pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve publik
2. Do të kryhet informimi i personave me aftësi ndryshe, ndihmë ekonomike dhe probleme sociale mbi të drejtat që gëzojnë nëpërmjet botimit të broshurave informative në gjuhë të kuptueshme
3. Do të zbatohen programe për mbështetjen me punësim, ndihmë ekonomike të veçantë, trajnim profesional për familjet me shumë fëmijë, familjet me PAK dhe atyre me probleme sociale
4. Do të ngrihen qendra të shërbimit social me vakte ushqimore për familjet në varfëri të tejskajshme në territorin e bashkisë
5. Do të ulet numri i personave me ndihmë ekonomike nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe punësimit në sektorin privat
6. Do të rritet pjesëmarrja e grave në vendimmarrje
7. Do të angazhohet dhe nxitet gruaja për krijimin e sipërmarrjeve sociale

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të kryhet riorganizim i transportit publik duke pasur parasysh të gjitha grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të kufizuar në territorin e bashkisë
2. Do të kryhet ndërtimi i rampave në trotuare në territorin e bashkisë
3. Do të inkurajohet heqja e pengesave në ndërtime në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e personave me aftësi ndryshe në hapësirat publike në territorin e bashkisë

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të hartohet dhe miratohet një politikë fiskale e cila do të parashikojë sigurimin e një stabiliteti të taksave dhe procedurat e administrimit të tyre dhe thjeshtimin e porçedurave të regjistrimit të biznesit dhe mbylljes së tij

2. Do të ketë lehtësira fiskale për taksën e ndikimit në infrastrukturë për investitorët që do të investojnë në zonë sipas projektit të zhvilluesit me vlerë investimi 300 000euro
3. Do të ulen në masën 30 % taksat e pasurisë (ndërtesa) ku zhvillohet aktiviteti
4. Do të sigurohet zgjidhja e problemit të pronësimit të tokës
5. Do të sigurohet finalizimi i regjistrimit të pronave përmes bashkëpunimit me ZVRPP
6. Do të nxiten e mbështeten aktivitete ekonomike me gratë dhe të rinjë sipërmarrës duke krijuar lehtësira fiskale për ato gra dhe të rinjë që nisin biznese të reja duke i përjashtuar nga taksat në fillimet e punës
7. Do të nxitet dhe mbështetet hapja e një qendre biznesi për prodhimet vendase nëpërmjet lehtësirave fiskale për tre vjet
8. Do të nxiten aktivitetet e fasonëve me mbi 100 punonjës nëpërmjet lehtësirave fiskale deri në tre vjet dhe do të vihen në dispozicion ambiente publike të Bashkisë Patos pa pagesë